

Ligji Nr. 05/L -009

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE I NDRYSHUAR DHE I PLOTËSUAR MË LIGJIN Nr. 04/L-111

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE I NDRYSHUAR DHE I PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr.04/L-111

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.31, 15 qershor 2008.

Neni 2

Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 4 fshihet në tërësi.

Neni 3

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 2 ndryshohet si në vijim:

7.2. Aksionari(ët) do të kërkojë nga Bordi i Drejtorëve që ta përgatisë dhe t'ia dorëzojë aksionari(ëve) një raport të hollësishëm në rast se: i. Përformanca e NP-së devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit të miratuar nga Bordi i Drejtorëve për vitin përkatës financiar; ii. Vlera e asetëve të NP zvogëlohet; iii. Bie niveli i kënaqësisë së konsumatorëve lidhur me cilësinë e shërbimeve. Në këto raste aksionari(ët) do të marrë parasysh masa të nevojshme korrigjuese.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3, në rreshtin e parë fjalia "në arritjen e caqeve të saj të performancës" zëvendësohet me "në kuptim të paragrafit 7.2 të këtij neni".

Neni 4

Neni 11 i ligjit bazik, pas paragrafit 11.2 shtohen paragrafët 11.3 dhe 11.4 me tekstin si në vijim:

11.3. Me propozim të Qeverisë, Kuvendi i Kosovës mund të marrë vendim që ta heqë nga kompetenca e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ndonjë ndërmarrje shoqërore, ose njësi të caktuara organizative të një ndërmarrjeje shoqërore, përfshirë asetet e tyre dhe ta autorizojë Qeverinë që këtë ndërmarrje shoqërore, përkatësisht njësi të caktuara organizative të një ndërmarrjeje shoqërore, t'i regjistrojë si ndërmarrje publike.

11.4. Me rastin e regjistrimit si ndërmarrje publike, ndërmarrja në fjalë i nënshtrohet ligjeve që zbatohen për ndërmarrjet publike dhe asetet e ndërmarrjes shoqërore, përkatësisht të njësisë së caktuar organizative të ndërmarrjes shoqërore do të konsiderohen si pjesë e Ndërmarrjes Publike.

Neni 5

Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, ndryshohet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

13.1. Ndërmarrjet publike iu nënshtrohen të gjitha akteve normative që rregullojnë shoqëritë tregtare përveç nëse me legjislacionin për ndërmarrjet publike rregullohet ndryshe. Riorganizimi, falimentimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve publike rregullohet me akt të veçantë ligjor.

Neni 6

Nenit 17 i ligjit bazik, pas paragrafit 17.4 shtohet një paragraf i ri 17.4a. me tekstin si në vijim:

17.4a. Përbërja e Bordeve të drejtorëve të NP-së duhet të jetë në harmoni me Ligjin për barazi gjinore.

Neni 7

Neni 29 i Ligjit bazik, i ndryshuar me Ligjin nr.04/L-111, riformulohet me tekstin si në vijim:

Bordet e NP-ve një herë në vit do ta masin kënaqësinë e konsumatorëve në bazë të procedurave përkatëse përmes organizatave kredibile të pavarura. Ky raport i dorëzohet (i) Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve më së largu deri më 31 mars për vitin paraprak, e cila e publikon atë në faqen e saj në internet dhe (ii) sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit(eve) përkatës Komunal të Aksionarëve.

Neni 8

Në Kreun VI, pas nenit 37 të ligjit bazik, shtohet neni 37.A me tekstin si në vijim:

Neni 37.A

Duke u nisur nga interesi i veçantë dhe rëndësia e saj statusi, organizimi dhe strukturimi i ndërmarrjes shoqërore, e regjistrua në regjistrat gjyqësorë me emërtimin: Kombinati Xehetaro - Metalurgjik Kimik Trepça, e cila aktualisht e bazuar në certifikatën e biznesit identifikohet me emërtimin "Trepça në administrimin e AKP-së", rregullohet me Strategji dhe Ligj të veçantë. Deri në miratimin e këtyre akteve kjo ndërmarrje do të vazhdojë të afarojë në kushtet aktuale, duke përfshirë edhe moratoriumin në pajtim me Ligjin mbi riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -009
7 prill 2015

Shpallur me dekretin Nr. DL-006-2015, datë 24.04.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga